



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-106 për teatrot, Rregullores nr. 02//2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores nr. 21//2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, Komuna e Vushtrrisë shpallë:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Institucioni :	Komuna e Vushtrrisë
Drejtoria:	Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i vendit të punës:	Drejtor i teatrit
Kategoria funksionale/Grada:	Koef. 7.5
Numri i referencës:	KRS/330/JP00029669

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën menaxhimin financiar,administrativ, teknik dhe promovues të teatrit;
- Zbaton vendimet e Këshillit Drejtues të teatrit;
- Propozon organizim e brendshëm të teatrit tek Këshilli Drejtues;
- Përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- Propozon buxhetin vjetor para Këshillit Drejtues;
- Kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
- Mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe donacioneve;
- Negocion dhe nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet me artistë të pavarur dhe me palë të tjera;
- Menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së teatrit;
- Menaxhon bashkëpunimin në nivel komunal dhe jashtë saj;
- Për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues;
- Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur vetëm për nëpunës civil ekzistues që i plotësojnë kushtet e nevojshme të përcaktuara me LSHCK si dhe kriteret e caktuara me këtë konkurs konkurs.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare nga fusha e teatrit ose nga lëmit tjera të përafërta të kulturës;

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen: katër (4) vjet përvojë pune profesionale; Njohuri dhe përvojë nga fusha e teatrit ose nga lëmit tjera të përafërta të kulturës; Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim; Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë; Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues; Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Exel, Power Point, Access);

Kohëzgjatja e emërimit: katër (4) vite.

Afati i konkurrimit: Tetë (8) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informacionit dhe në tabelë të shpalljeve të komunës.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse, në Komunën e Vushtrrisë. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës dhe ti bashkëngjiten këto dokumente: diploma mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës; kopjet e vlerësimit për 2 vitet e fundit. Dokumentet duhet të jenë në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të komunës.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku